

VENDIM
I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË
“ORDEROO” SH.P.K.

Sot, më datë 3/09/2023, në selinë e shoqërisë “ORDEROO” SH.P.K., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në datën 15/07/2020, me numër unik identifikimi të subjektit (NUIS) M01920003E, në adresën: Rruga “Komuna e Parisit”, Kompleksi “Niku Construction”, Kati i 8, Ap. nr. 73, Tiranë, Shqipëri (këtu e në vijim “**Shoqëria**”), u zhvillua mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

Janë të pranishëm në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, Ortakët:

1. **Z. Aleksander Risilia**, shtetas shqiptar, atësia Gjergj, lindur më 21/05/1990, në Vlorë dhe banues në Tiranë, në adresën: Rruga “Haxhi Kika”, Nr. 140/1, mbajtës i letërnjoftim ID Nr. 036313945 dhe Nr.Personal J00521067U, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, **në cilësinë e Ortakut zotërues të 45% të kapitalit të Shoqërisë;**
2. **Z. Qamil Aliaj**, shtetas shqiptar, atësia Pano, lindur më 30/03/1963, në Vlorë dhe banues në Vlorë, në adresën: Lagjia Dëshmorët, Rruga “De Rada”, mbajtës i letërnjoftim ID Nr. 038533755 dhe Nr.Personal G30330142E, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, **në cilësinë e Ortakut zotërues të 30% të kapitalit të Shoqërisë;**
3. **Z. Ilir Tesho**, shtetas shqiptar, atësia Gjergji, lindur më 11/05/1989, në Tiranë dhe banues në Tiranë, në adresën: Rruga “Mihal Popi”, Shk. 33, Ap. 5, mbajtës i letërnjoftim ID Nr. 034014072 dhe Nr.Personal I90511070V, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, **në cilësinë e Ortakut zotërues të 25% të kapitalit të Shoqërisë.**

Meqënëse në mbledhje janë të pranishëm Ortakët që përfaqësojnë 100% të kapitalit themeltar të Shoqërisë, mbledhja konsiderohet e vlefshme për të vendosur në lidhje me rendin e ditës si më poshtë vijon:

RENDI I DITËS

1. Miratimi i transferimit nëpërmjet shitjes së një pjese të kapitalit të Shoqërisë të zotëruar nga Ortakët e Shoqërisë në favor të shoqërisë “Blessed Investment” Sh.p.k. dhe shoqërisë “Landways Investment” Sh.p.k.
2. Regjistrimi i vendimit të asamblesë dhe kontratave të shitblerjes në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) me qëllim evidentimin e ndryshimeve në kapitalin e Shoqërisë.
3. Miratimi i marrjes së një huaje në shumën e përgjithshme prej 350,000 Euro (treqind e pesëdhjetë mijë euro) nga shoqëritë “Blessed Investment” Sh.p.k. dhe “Landways Investment” Sh.p.k., me qëllim ushtrimin e veprimtarisë së Shoqërisë dhe kryerjen e pagesave.
4. Autorizimi i Administratorit të Shoqërisë për të nënshkruar kontratat e huasë dhe çdo dokument të nevojshëm për përmbushjen e qëllimit në pikën (3) të rendit të ditës.



Në lidhje me pikën e parë të Rendit të Ditës, Ortakët e Shoqërisë diskutuan për transferimin nëpërmjet shitjes së një pjese të kapitalit të Shoqërisë të zotëruar nga Ortakët e Shoqërisë tek palë të treta, sipas kërkesës së Ortakëve dhe në përputhje me parashikimet e Statutit dhe akteve ligjore, dhe më konkretisht:


- (i) Ortaku i Shoqërisë Z. Aleksander Risilia synon të kalojë pronësinë nëpërmjet shitjes të një pjese të kuotës që zotëron në kapitalin e Shoqërisë, të barabartë me 5% të pjesëmarrjes në kapitalin e Shoqërisë, në favor të shoqërisë “Blessed Investment” Sh.p.k. dhe të një pjese të kuotës që zotëron në kapitalin e Shoqërisë, të barabartë me 1.5% të pjesëmarrjes në kapitalin e Shoqërisë, në favor të shoqërisë “Landways International” Sh.p.k.
- (ii) Ortaku i Shoqërisë Z. Qamil Aliaj synon të kalojë pronësinë nëpërmjet shitjes të kuotës që zotëron në kapitalin e Shoqërisë, dhe më konkretisht një pjesë të kuotës së tij të barabartë me 15% të pjesëmarrjes në kapitalin e Shoqërisë, në favor të shoqërisë “Blessed Investment” Sh.p.k. dhe një pjesë të kuotës së tij të barabartë me 15% të pjesëmarrjes në kapitalin e Shoqërisë, në favor të shoqërisë “Landways International” Sh.p.k.
- (iii) Ortaku i Shoqërisë Z. Ilir Tesho synon të kalojë pronësinë nëpërmjet shitjes të një pjese që zotëron në kapitalin e Shoqërisë, të barabartë me 3.5% të pjesëmarrjes në kapitalin e Shoqërisë, në favor të shoqërisë “Landways International” Sh.p.k.

Pas realizimit të kalimit të pjesëve të kapitalit si më lart, Shoqëria do të ketë 4 (katër) Ortakë dhe secili prej Ortakëve do të zotërojë nga një kuotë në kapitalin e Shoqërisë, e shprehur në përqindje dhe në vlerë nominale si më poshtë vijon:

- (i) Z. Aleksander Risilia do të zotërojë 1 (një) kuotë që përfaqëson 38.5% të kapitalit të Shoqërisë, me vlerë nominale 38,500 (tridhjetë e tetë mijë e pesëqind) Lekë;
- (ii) Z. Ilir Tesho do të zotërojë 1 (një) kuotë që përfaqëson 21.5% të kapitalit të Shoqërisë, me vlerë nominale 21,500 (njëzetë e një mijë e pesëqind) Lekë;
- (iii) shoqëria “Blessed Investment” Sh.p.k. do të zotërojë 1 (një) kuotë që përfaqëson 20% të kapitalit të Shoqërisë, me vlerë nominale 20,000 (njëzetë mijë) Lekë;
- (iv) shoqëria “Landways International” Sh.p.k. do të zotërojë 1 (një) kuotë që përfaqëson 20% të kapitalit të Shoqërisë, me vlerë nominale 20,000 (njëzetë mijë) Lekë.


Në lidhje me pikën e tretë të Rendit të Ditës, me qëllim realizimin dhe në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së saj tregtare, Shoqëria ka nevojë për likuiditet për kryerjen e pagesave të ndryshme. Shoqëritë “Blessed Investment” Sh.p.k. dhe “Landways International” Sh.p.k. kanë rënë dakord të japin një hua për Shoqërinë për t’ju përgjigjur kërkesave dhe nevojave të saj. Kjo hua do të jepet në kuadër të marrëdhënies së shitblerjes së kuotave nga shoqëritë “Blessed Investment” dhe “Landways International” Sh.p.k. në kapitalin e Shoqërisë sipas pikës 1 të Rendit të Ditës.

Në vijim të sa më sipër, dhe në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe legjislacionin shoqiptar të zbatuar në Republikën e Shqipërisë, pasi shqyrtoi me vëmendje çështjet e trajtuara në rendin e ditës, në përfundim të diskutimeve Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë unanimisht,



VENDOSI:

1. Të miratojë transferimin nëpërmjet shitjes së një pjese të barabartë me 5% të pjesëmarrjes në kapitalin e Shoqërisë nga Ortaku Z. Aleksander Risilia, në favor të shoqërisë “Blessed Investment” Sh.p.k., sipas kontratës së shitblerjes së kuotës dhe kundrejt shpërblimit të përcaktuar në kontratën që do të lidhet midis palëve për këtë qëllim.
2. Të miratojë transferimin nëpërmjet shitjes së një pjese të barabartë me 1.5% të pjesëmarrjes në kapitalin e Shoqërisë nga Ortaku Z. Aleksander Risilia, në favor të shoqërisë “Landways International” Sh.p.k., sipas kontratës së shitblerjes së kuotës dhe kundrejt shpërblimit të përcaktuar në kontratën që do të lidhet midis palëve për këtë qëllim.
3. Të miratojë transferimin nëpërmjet shitjes të kuotës që zotëron Ortaku Z. Qamil Aliaj duke shitur një pjesë të barabartë me 15% të pjesëmarrjes në kapitalin e Shoqërisë në favor të shoqërisë “Blessed Investment” Sh.p.k. dhe pjesën tjetër të barabartë me 15% të pjesëmarrjes në kapitalin e Shoqërisë në favor të shoqërisë “Landways International” Sh.p.k., sipas kontratave të shitblerjes së kuotës dhe kundrejt shpërblimit të përcaktuar në kontratat që do të lidhen midis palëve për këtë qëllim.
4. Të miratojë transferimin nëpërmjet shitjes së një pjese të barabartë me 3.5% të pjesëmarrjes në kapitalin e Shoqërisë nga Ortaku Z. Ilir Tesho, në favor të shoqërisë “Landways International” Sh.p.k., sipas kontratës së shitblerjes së kuotës dhe kundrejt shpërblimit të përcaktuar në kontratën që do të lidhet midis palëve për këtë qëllim.
5. Pas transferimit të pjesëve të kapitalit të Shoqërisë të miratuara sipas këtij Vendimi, struktura e kapitalit të Shoqërisë do të jetë si më poshtë vijon:
 - (i) Z. Aleksander Risilia do të zotërojë 1 (një) kuotë që përfaqëson 38.5% të kapitalit të Shoqërisë, me vlerë nominale 38,500 (tridhjetë e tetë mijë e pesëqind) Lekë;
 - (ii) Z. Ilir Tesho do të zotërojë 1 (një) kuotë që përfaqëson 21.5% të kapitalit të Shoqërisë, me vlerë nominale 21,500 (njëzetë e një mijë e pesëqind) Lekë;
 - (iii) shoqëria “Blessed Investment” Sh.p.k. do të zotërojë 1 (një) kuotë që përfaqëson 20% të kapitalit të Shoqërisë, me vlerë nominale 20,000 (njëzetë mijë) Lekë;
 - (iv) shoqëria “Landways International” Sh.p.k. do të zotërojë 1 (një) kuotë që përfaqëson 20% të kapitalit të Shoqërisë, me vlerë nominale 20,000 (njëzetë mijë) Lekë.
6. Depozitim dhe regjistrimin e këtij Vendimi të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë dhe kontratave të shitblerjes në QKB me qëllim evidentimin e ndryshimeve në pjesëmarrjen e kapitalit të Shoqërisë të miratuara sipas këtij Vendimi.
7. Shoqëria të marrë një hua në shumën e përgjithshme prej 350,000 Euro (treqind e pesëdhjetë mijë euro), dhe më konkretisht shumën prej 175,000 Euro (njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë euro) do ta marrë hua nga shoqëria “Blessed Investment” Sh.p.k., dhe shumën prej 175,000 Euro (njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë euro) do ta marrë hua nga shoqëria “Landways International” Sh.p.k. Huaja do të jetë pa interes dhe për një afat prej 5 (pesë) vjet. Kjo hua do të përdoret nga Shoqëria si vijon:
 - (i) shumën prej 150,000 Euro (njëqind e pesëdhjetë mijë euro) do të përdoret për ushtrimin e veprimtarisë së Shoqërisë dhe kryerjen e pagesave kundrejt të tretëve, dhe (ii) shumën prej 200,000



Euro (dyqind mijë euro) do të përdoret për kthimin e huasë së marrë nga Ortaku Z.Qamil Aliaj sipas Kontratës së Financimit datë 29/07/2020.


8. Të autorizojë Administratorin e Shoqërisë Z. Ilir Tesho për të nënshkruar në emër dhe për llogari të Shoqërisë kontratat e huasë të miratuar sipas pikës 7 të këtij Vendimi, si dhe duke mos u kufizuar të nënshkruajë dhe çdo dokument tjetër dhe të kryejë çdo veprim të nevojshëm për përmbushjen e qëllimit sipas pikës 7 më lart të këtij Vendimi.

Duke mos pasur çështje të tjera për të vendosur, ky Vendim nënshkruhet rregullisht në 3 (tre) kopje origjinale nga Ortakët e Shoqërisë.

**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E SHOQËRISË
"ORDEROO" SH.P.K.**

ORTAKËT:


Z. Aleksander Risllia







Z. Qamil Aliaj



Z. Ilir Tesho

